



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.176/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore, Anita Peci duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së banerëve mbi rrugë publike për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 650 (gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 10.10.2017, aktivistët e tyre kanë vërejtur se në rrugën “ Dëshmorët e Kombit” në Prishtinë mbi rrugë publike ishte vendosur baneri i kandidatit për Kryetar të Komunës së Prishtinës nga radhët e AKR-së.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b), të LPZ-së, të dispozitës së nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 11.10.2017 Aleanca Kosova e Re (AKR), ka theksuar se vendosja e banerit është bërë pa qenë në dijeni strukturat e AKR-së, megjithatë pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur fotografi nga vendi ku është larguar baneri.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

## Ankesa është e bazuar

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për Kryetar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik AKR, është vendosur mbi rrugë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik AKR, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që baner të kandidatit për Kryetar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik AKR, janë vendosur mbi rrugë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Aleanca Kosova e Re (AKR) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti baner të kandidatëve të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr banerët nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**  
ZL.Anr.176/2017 me datën 12.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.